



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJESIA E PROKURIMIT

Nr _____ Prot

Datë, më _____._____.2026

PROCES-VERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti: Rikonstruktion i rruges "Jakov Xoxa", tek Ish-Frigoriferi

Fondi Limit: 85,895,737.13 (Tetedhjetë e pesemilion e teteqind e nentedhjetë e e pesemije e shtateqind e tridhjetë e shtatë pike trembedhjetë) **Leke pa TVSH.**

REF-96458-08-17-2026

Kodi CPV: Kodi CPV: 45210000-2 - Punime ndërtimi

Tipi i procedures : E hapur pune

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Vlore** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Argumentimi: Kërkesat e mëposhtme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kerkesat e mesiperme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet tatimore dhe ato të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit të ofertes është detyrim ligjor i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi mesipercituar, si një mjet garancie për AK në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b) Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (regjistrat tregtarë, sipas nenit 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së) dhe të kete në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, Nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Ofertuesve nuk u lejohet mbështetja në kapacitet e subjekteve të tjera, pasi xhiroja vjetore vlerësohet si kapacitete të lidhura ngushtësisht me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme për shkak të rëndësisë së veprës, punimeve në fasadë dhe punimeve në objekt prokurimi, dhe janë të nevojshme për të krijuar bindjen të Autoriteti Kontraktor se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standarteve të kërkuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku përcaktohet se: ”Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është “E Hapur – Punë Publike - ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar – Prokurim publik me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma ”a” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: ”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros (jo më e vogël se vlera e kontratës) është brenda marzhit të lejuar që mund të kërkohej. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që operojnë në treg si dhe për rritur numrin e konkurrentëve në këtë procedure është gjykuar që vlera e xhiros së kërkuar të jete minimalisht sa vlera e parashikuar e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

- Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për kestet e maturuara te vitit 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar).
 - (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi Ligjor dhe teknik . Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre Kjo kerkese eshte vendosur me qëllim që AK të ketë mundësinë të shohë nëse OE pjesmarrës kanë apo jo detyrime ndaj NJ.Q.V, fakt që tregon fleksibilitetin e tyre financiar.

- Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore të 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuara nga organet tatimore si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit).

Argumentimi Ligjor dhe teknik : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në Nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore“ ”Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars

të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose

shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël"

2.1.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për keestet e maturuara te vitit 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar).

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

2.3Kapaciteti teknik:

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **40%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet , te realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është ne një vlere jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika1/ a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me sektorin publik,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Akt kolaudimi objekti;
- Fature tatimore perkatese të deklaruar në organet tatimore.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Ofertuesve nuk u lejohet mbështetja në kapacitet e subjekteve të tjera, pasi pune të ngjashme janë, përvoja për të zbatuar kontratën vlerësohen si kapacitet të lidhur ngushtësisht me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme për shkak të rëndësisë së veprës, punimeve në fasadë dhe punimeve në objekt prokurimi, dhe janë të nevojshme për të krijuar bindjen te Autoriteti Kontraktor se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standarteve të kërkuara.

Argumentimi Ligjor dhe Teknik : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat..50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses kontratën objekt prokurimi, sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në mbështetje të Nenit 88, pika 3 e VKM 285/2021, parashikon se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht”

Në mbështetje të Nenit 88, pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.

Pra në rastet e BOE, dokumentacioni i kerkuar per te vertetuar përvojen e meparshme si kontrata e bashkepunimit, disponohen nga çdo OE në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që ka çdo shoqeri në dosjen e saj ne rastin kur ka qene ne ate status, e per rrjedhoje nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore të prokurimit publik dhe nuk sjelle asnje kufizim te pjesmarrjes se OE ne proceduren e prokurimit ne fjale.

2.3- Licensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, Për miratimin e rregullave për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme në ndërtim :

- Kategoria NP-1 Niveli A “Punime gjurmimi në tokë”.
- Kategoria NP-3 Niveli B “Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada”
- Kategoria NP-4 Niveli B “Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale”
- Kategoria NP-7 Niveli A “Ujësjellës kanalizime, vepra kullimi vaditje, Ndërtim konstruksioni ujësjellëse, rrjete kanalizimi te ujrave te bardha dhe te zeza, vepra hidraulike te ngjashme”.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- Kategoria NS-1 Niveli A “Punime per prishjen e ndërtimeve”
- Kategoria NS-4 Niveli B “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtesës”.
- Kategoria NS-6 Niveli A Sinjalistike rrugore
- Kategoria NS-12 Niveli A. Punime te Inxhinierise te mjedisit
- Kategoria NS-18 Niveli A “Punime Topogjeodezike.”

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Ofertuesve nuk u lejohet mbështetja në kapacitet e subjekteve të tjera pasi licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh vlerësohen si kapacitete të lidhur ngushtësisht me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme për shkak të rëndësisë së veprës, punimeve në fasadë dhe punimeve në objekt prokurimi, dhe janë të nevojshme për të krijuar bindjen te Autoriteti Kontraktor se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standarteve të kërkuara.

Argumentimi Ligjor dhe Teknik : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së

licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 ku përcaktohet se: çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm në klasat dhe kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në licencë. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë subjekti juridik për të fituar klasa e kategori në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përcaktohen në rregulloren për dhënien e licencave profesionale, që miraton Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

2.4 Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga QKB me Licencë kategoria III.2.B për “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme ”

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, licencat e mesiperme duhet te disponohen nga anetari qe do te kryejë shërbimet perkatese).

Ministrave nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” i ndryshuar. Këto kode shërbejnë për të klasifikuar mbetjet që gjenerohen gjatë punimeve, me qëllim menaxhimin, transportin dhe depozitimin e tyre të saktë ligjor, Kodi 17 05 04 Dhera dhe gurë (të ndryshëm nga ato që përmbajnë substanca të rrezikshme). Ky është kodi kryesor për gërmimet. Përdoret për dherat e pastra që hiqen nga objekti për të hapur trupin e rrugës, Kodi 17 09 04 Mbetje të përziera ndërtimi dhe prishjeje. Përdoret nëse gjatë rrugës hasni mbetje betoni, tullash apo mbetje të tjera nga struktura të vjetra ekzistuese, Kodi 17 03 02 Përzierje bituminoze (asfalt pa katran). Duhet nëse projekti parashikon gërryerjen (frezimin) e asfaltit ekzistues ose nëse ka mbetje asfalti gjatë shtrimit, në rastin tone kemi në preventive “Skarifikim shtresash asfalti ekzistuese.

Argumentimi Ligjor dhe Teknik : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendim Nr. 538 date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa”. si dhe ne permbushje te detyrimeve ligjore qe percakton Ligji 10431 date 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (te ndryshuar).

Ky kriter synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve te ngurta, nepermjet administrimit mjedisor te tyre ne cdo faze, perfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, perpunimin, magazinimin, asgjësimin, te cilat cojne ne pakesimin e mbetjeve dhe zvogelimin e ndikimeve te tyre te rrezikshme e te demshme. Duke qene se ne preventivin e punimeve jane pasqyruar punime prishje, germimi eshte gjykuar qe subjekti duhet te kete lejen e posacme per veprimtari te tilla si Stacionim transferimi per mbetjet nga prishjet dhe ndertimet, per mbetjet e ngurta urbane dhe magazinim i perkoshem i tyre.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat/lejet profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e proceseve te punes te parashikuara ne preventivin objekt kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

2.5. Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt sipas Neni 8**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Ofertuesve nuk u lejohet mbështetja në kapacitet e subjekteve të tjera si dhe drejtuesi teknik i sipërpërmendur, vlerësohen si kapacitete të lidhur ngushtësisht me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme për shkak të rëndësisë së veprës, punimeve në fasadë dhe punimeve në objekt prokurimi, dhe janë të nevojshme për të krijuar bindjen te Autoriteti Kontraktor se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standarteve të kërkuara.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e

dokumente provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Ligjor dhe Teknik : Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe në nenin 39, pika 6, gërma “c” të VKM-se Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune, sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.6 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe staf (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë) të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë/certifikatë/dëshmi përkatëse si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimit si “*Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë*” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akredites të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10237 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullave për sigurinë në kantier”.
- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- 5 (pesë) Punonjës Specialist të Certifikuar si “Specialist për punimet në lartësi”, sipas V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", te cilat te jene te leshuara nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë;

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi Ligjor dhe Teknik : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Argumentimi teknik dhe Ligjor : Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010" Për sigurinë dhe shëndetin në punë "Neni 7

Sherbimet e mbrojtjes dhe te parandalimit 1. Punedhenesi ngarkon nje ose disa punemarres, qe te merren me ceshtjet e mbrojtjes, te sigurise e shendetit ne pune dhe te parandalimit te rreziqeve profesionale ne ndermarrje /institucion, dhe V.K.M nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier ". Autoriteti Kontraktor ka qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi sipas kushteve te percaktuara ne DST, duke respektuar cdo rregull lidhur me kantierin e ndertimit si dhe me sigurine e punonjesve gjate ushtrimit te veprimtarise se punes. Eshte e rendesishme qe punimet te realizohen brenda nje kantieri te sigurt duke mbrojtur jeten e punonjesve, por dhe te kalimtareve qe mund te jene perreth vendit te punimeve.

Per sa me lart, punonjesi i cili eshte i certifikuar si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune", nepermjet dijes dhe eksperiences te fituar ne kete fushe, duhet te shmange apo parandaloje cdo rrezik qe mund te shfaqet gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe mund te cenoje shendetin apo sigurine ne pune. Ne keto kushte, vendosja e ketij kriteri sherben si nje garanci qe ofertuesit do te reazlizojne punimet sipas standarteve ligjore ne fuqi.Bazuar dhe ne V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit.Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.7 Operatori Ekonomik duhet të kete fuqi minimale punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej mesatarisht 60 (gjashtedhjetë) persona, 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per 3 muajt fundit te deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi teknik dhe Ligjor : Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale te lejuar qe duhen per te permbushur kontratesn. Numri i punonjësve dheqëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje per 3 (tre) muajt e fundit, te deklaruar nga data e hapjes se ofertave j, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikën sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim te paktën 60 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike jane bazuar ne VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” .Bazuar ne kater elementet e struktures se koston(material, puntori, makineri, transport).

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

2.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar / të kualifikuar, si dhe të përfshijë në listëpagesat për tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit, me profesionet si mëposhtë:

- 1 (një) Teknik Ndërtimi;
- 1 (një) Teknik Mekanik;
- 2 (dy) elektrikist;
- 2 (dy) saldator;
- 3 (tre) betonues;
- 2 (dy) murator/ suvatues;
- 2 (dy) karpentier;
- 8 (tete) specialist veshje fasade;
- 4 (kater) specialist punime rrugore dhe Asfaltoshtrues;

- 2 (dy) hidraulike;
- 2 (dy) karpentier;
- 2 (dy) Hekurthyes;
- 10 (dhjete) punonjes te thjeshte
- 2 (dy) Manovratore ;
- 2 (dy) shofere për drejtim mjetesh të pajisur me leje drejtimi me kategorinë "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE" leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve, objekt kontrate, diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas Ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Shënim: Për shoferët, eskavatoristët, manovratorët Operatori Ekonomik pjesëmarrës mund t'i disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundim të kontratës.

- të vertetuar me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë .

- Për punonjësit me profesionet si më sipër cituar, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, operatorët ekonomik ofertues duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/certifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore.

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të paraqesë punonjësit e mesipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Shënim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me

originalin”.

Argumentim Ligjor dhe Teknik : Në kriterin mesipercituar është kërkuar që OE të kenë të punësuar teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Punëtorët e ndërtimit dhe profesionet e lidhura me to ndërtojnë, mirëmbajnë dhe riparojnë ndërtesat dhe strukturat e tjera që nga themelet, muret dhe pjesët e tjera kryesore të ndërtesës dhe konstruksione të tjera, si jashtë ashtu edhe brenda duke përdorur teknika dhe materiale tradicionale apo moderne të ndërtimit. Ata kryejnë punime murature, suvatime, shtrim pllakash dhe parketesh, lyerje me bojë etj. Nisur nga punimet e parashikuara të zbatimit, në kriteret e veçanta janë kërkuar punëtorët e kualifikuar si vijon:

Teknik ndërtimi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin.

-Për zbatimin e punimeve ndërtimore të tilla si punimet e gërmimit, punimet strukturore, punimet e shtresave, rifiniturave, punimet e dyerve dhe dritareve, punimet hidraulike, punimet e tarracës, punimet e konstruksioneve metalike janë kërkuar 2 (dy) teknikë ndërtimi. Kjo është një kërkesë shumë minimale, duke marrë parasysh vëllimin e madh të punimeve dhe grafikun e punimeve.

Teknik mekanik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike që lidhen me montimin e pajisjeve dhe elementëve mekanikë, duke garantuar realizimin e tyre në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe standardet në fuqi. Për zbatimin e këtyre punimeve kërkohet 1 (një) teknik mekanik, duke marrë parasysh natyrën e specializuar të punimeve, rëndësinë e montimit të saktë të elementëve mekanikë dhe nevojën për garantimin e cilësisë, funksionalitetit dhe sigurisë gjatë ekzekutimit të kontratës. Prania e këtij specialisti është e domosdoshme për të siguruar realizimin korrekt të punimeve mekanike dhe respektimin e kërkesave teknike të projektit.

-Elektracist -është përgjegjës për zbatimin e punimeve elektrike dhe elektronike, të tilla si punimet për kuadrot elektrikë, sistemin e fuqisë dhe ndriçimit, sistemi i mbrotjes nga shkarkimet atmosferike dhe tokëzimi, punimet për motimin e transformatoreve, si dhe punimet për lidhjen e rrjeteve me infrastrukturën publike. Elektracisti merret me ndërtim, montim, instalim dhe riparim të sistemit elektrik në ndërtesa të ndryshme civile, objekteve social kulturore apo industriale etj. Elektracisti monton, instalon, riparon dhe mirëmban makineri dhe pajisjeve elektrike civile dhe industriale. Punimet elektrike zënë një vend të rëndësishëm në prevetivin total të punimeve, si nga pikëpamja e sasisë, ashtu edhe të vlerave.

Hidraulik -është përgjegjës për realizimin e punimeve hidraulike si ndërtime, montime, instalime, riparime dhe mirëmbajtje të sistemit hidraulik, të sistemit të ujësjellës kanalizimeve, të sistemit të ujitjes, sistemeve të ngrohje-ftohjes, të sistemeve hidraulike të objekteve të prodhimit industrial dhe objekte të tjera që përdorin sisteme hidraulike të ngjashme.

Për zbatimin e këtyre punimeve kërkohet 1 (një) termohidraulik, duke marrë parasysh natyrën e specializuar të punimeve, rëndësinë e instalimit korrekt të sistemeve termohidraulike, si dhe nevojën për garantimin e cilësisë, funksionalitetit dhe sigurisë gjatë ekzekutimit të kontratës. Prania e këtij specialisti është e domosdoshme për të siguruar realizimin e punimeve sipas kërkesave teknike të projektit dhe funksionimin e sigurt e efikas të sistemeve të instaluar.

Specialiste punime ngrohje-ftohje -është përgjegjës për zbatimin e punimeve për instalimin e kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse në të gjithë vëllimet e objektit. Sipas Listës Shqiptare të Profesioneve, instaluesi dhe riparuesi i kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse merret me parapërgatitjen, montimin dhe instalimin e kondicionerëve, kaldajave, paneleve diellore, çillërave (sistemeve ngrohëse-ftohëse), si dhe kryen riparime apo punime mirëmbajtjeje në sistemet e ngrohje-ftohjes. Referuar prevetivit të punimeve janë shume pajisje për tu montuar, pa llogaritur pajisjet e vogla, tubat dhe rakorderitë. Konkretisht për kryerjen e punimeve për zërat e punimeve për instalimin e kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse

Murator dhe Suvatues - Punimet e muraturës në objektin që ndërtohet parashikojnë ndërtimin e të gjithë mureve në vëllimet që ndërtohen si dhe suvatimet e jashtme dhe të brendshme, përzgjedhin materialet e nevojshme dhe veglat e punës para fillimit të procesit të punës, respektojnë me rigorozitet radhën e kryerjes së çdo procesi pune sipas orientimit të dhënë në objekt, bëjnë përgatitjen e sasisë së nevojshme të llacit për procesin ditor të punës, duke respektuar porcionet e duhura të materialeve përbërëse, bëjnë breza përforcues betoni në gjysmën e lartësisë së murit ose sipas specifikimit në projekt, kontrollojnë nëse muret janë të lidhur midis tyre horizontalisht dhe vertikalisht duke garantuar kështu qëndrueshmërinë e tyre, ndërtojnë soletat, vendosin arkitrarët e dyerve dhe dritareve, vendosin kondrakasat e dyerve dhe dritareve, nëse ka të tilla të parashikuara në projekt, bëjnë mbushjen me llac të mureve në nivelin e fashove me dorë ose me pompë në varësi të materialit të përcaktuar nga drejtuesi teknik në objekt, përgatitin materialin e nevojshëm për tavane me gips apo për tavane të varura zbkurues duke bërë matjet dhe prerjet e duhura, bëjnë stukime apo riparimet e duhura të objekteve të ndryshme, bëjnë kontrollin përfundimtar të punimeve, duke u siguruar që gjithçka është sipas përshkrimit në projekt etj.

Specialiste punime durale .Do të realizojë vendosje të dyerve të brendshme, dyerve të blinduara, vetratave etj.

Betonuesi është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të betonimit në objekt, sipas zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin

-**Karpentier** është i nevojshëm për përgatitjen e kallëpeve të betonit dhe skelerive sipas zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin. Punimet e betonit dhe b/a të parashikuara në projektin konstruktiv, specifikimet teknike, preventivin dhe grafikun e punimeve lidhen ngushtë me proceset e derdhjes së betonit, pjesë e të cilave është edhe përgatitja e kallëpëve. Krahas punimeve të betonit dhe betonarmesë parashikohet edhe ndërtimi i skelave, të cilat krahas strukturave metalike parashikojnë edhe shumë punime druri. Karpentierët. realizojnë punime të tilla si kryerjen e matjeve dhe prerjeve sipas përmasave të përcaktuara në projekt, bëjnë piketimin dhe armaturën anësore të themelit, bëjnë vendosjen e modinave për kolonat dhe muret e betonit sipas projektit, ndërtojnë armaturën, kallëpet e kolonave, mureve, shkallëve, urave apo strukturave të tjera, duke respektuar radhën e punës, me materiale druri, plastike, apo metalike sipas specifikimeve teknike, montojnë skelerinë përforcuese për fazën e betonimit të mureve dhe kolonave, kontrollojnë vertikalishtet e armaturës (peshon) me plumbçe, nxjerrin kuotat e lartësisë së katit sipas projektit (para betonimit), lagin armaturën para betonimit, ndërtojnë skelën për armaturën e trarëve dhe soletës duke ndjekur proceset e tjera të punës, vendosin polisterolin ose tullat në soletë apo në struktura të tjera (për rastin e soletave të lehtësuara), bëjnë disarmimin e kolonave, mureve dhe soletës apo strukturave të tjera duke respektuar afatet e duhura, kryejnë pastrimin dhe sistemimin e armaturës etj.

Hekurkthyes -Në preventivin e punimeve është parashikuar një sasi e madhe punimesh betoni dhe betonarmeje. Hekur betoni periodik është parashikuar në sasinë 279 ton. Hekurkthyesit nevojiten për realizimin e punimeve të tilla si matjet e duhura të hekurit duke respektuar tolerancat teknike, prerja e hekurit sipas përmasave të duhura duke eliminuar mbetjet (sa më pak firo), vendosjen e hekurit sipas specifikimeve të projektit, “mbjelljen” e kolonave në bashkëpunim me topografin ose inxhinierin e zbatimit për strukturat vertikale (kolona, mure anësore etj.), montimin (lidhjen) e hekurit sipas specifikimeve të përcaktuara, lidhjen e hekurave të soletës (që mund të jetë monolite ose të lehtësuara), etj. Realizimi i punimeve të tilla lidhet me qëndrueshmërinë e të gjithë strukturës dhe duhet detyrimisht të realizohet nga punëtorë të kualifikuar.

Specialist veshje fasade - është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të veshjes së fasadës, duke përfshirë montimin e sistemit të fasadës, vendosjen e materialeve izoluese dhe elementëve përfundimtarë, në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe standardet në fuqi.

Eskavatoristi është përgjegjës për operimin e eskavatorit në punimet e gërmimit, sistemimit dhe përgatitjes së terrenit, në përputhje me projektin dhe specifikimet teknike.

Shoferi është përgjegjës për transportin e materialeve, pajisjeve dhe mjeteve të punës në kantier, duke garantuar furnizimin e pandërprerë të punimeve dhe respektimin e rregullave të sigurisë rrugore dhe në punë.

2.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, ***drejtues teknik në licencën e shoqërisë ofertuese***, si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi profili Strukturist 1(një)
- Inxhinier Mekanik 1(një)
- Inxhinier Hidroteknik 1(një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)

Stafi teknik i sipërcituar duhet të figurojë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, CV.

-Inxhinier ndertimi profili strukturë:Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një sasi dhe tipologji të madhe të punimeve të përgjithshme ndërtimore, të tilla si punimet e prishjes, punimet e gërmimit, punimet e shtresave, punimet e muraturës, punimet e konstruksionit metalik, punimet e pilotave, suvatimet, hidroizolimet, sistemit e jeshtme etj. Punimet ndërtimore përbëjnë pjesën më të madhe të vëllimit të punëve për zbatimin e projektit, sikurse edhe ato më komplekset. Punimet e ndërtimit duhet të përmbushin kushtet teknike të zbatimit. Respektimi i kërkesave për qëndrueshmëri strukturore dhe qëndrueshmëri, plotësimi i kërkesave për mbrojtjen pasive nga zjarri, përdorimi i materialeve që nuk janë të dëmshëm për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve dhe saktësia në realizimin e të gjithë elementëve konstruktivë sjellin domosdoshmërinë që çdo element dhe hallkë e zbatimit të këtyre punimeve të ndiqet dhe udhëhiqet nga ekspertë të licensuar të fushës.

Zbatimi i punimeve të përgjithshme ndërtimore dhe zbatimi i punimeve strukturore duhet të realizohet me materialet dhe teknologjitë e parashikuara në projektin e zbatimit, metodologjia e ndekur e zbatimit të këtyre punimeve duhet të përputhet me specifikimet teknike dhe standardet dhe kriteret e zbatimit nga ekspert inxhinier ndërtimi, i profilit strukturist. Ndjekja e të gjithë procesit ndërtimor që në fazën e pastrimit të sheshit, punimet e ngritjes së kantierit, skelerive, objekteve ndihmëse, punimet e muraturës, punimet e shtresave izoluese, realizimi i

daljeve për sistemet teknike të ndërtesës realizimi i strukturës mbajtëse, punimet e përforcimit strukturor, punimet për realizimin e konstruksioneve metalike të thjeshta dhe të përbëra janë punime të parashikuara në projektet e punimeve ndërtimore dhe në preventivin respektiv. Të tilla punime janë parashikuar për ndërtimin e objektit prokurorimi". Për ndjekjen e punimeve të përgjithshme ndërtimore dhe punimeve strukturore në këtë objekt do të ishte e nevojshme të angazhohet një inxhinierë ndërtimi strukturistë i licesnuar, dhe të jete i përfshirë në licensën e shoqërisë.

Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit si dhe për sigurimin teknik në proceset e punës. Ky inxhinier ka për qëllim menaxhimin e zbatimit të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit pasi kemi të bëjmë me punime ndërtimi apo rikonstruksioni, ndjekjen e ecurisë së punimeve në kantier;

- Inxhinier mekanik Projekti që do të zbatohet nëpërmjet kësaj procedure prokurimi përmban si komponent të tij edhe projektin HVAC (projektin e ngrohjes ftohjes dhe ventilimit). Ky projekt përmban zgjidhjet grafike, relacionin teknik, specifikimet teknike dhe preventivin e realizimit të punimeve të tilla. Realizimi i këtij projekti për të gjithë vëllimet e objektit është shumë i rëndësishëm për sigurimin e komfortit termik në ambiente. Sikurse shtjellohet në realcionin teknik përkatës, *parametrat projektuese të projektit janë marrë në përputhje me tipin dhe destinacionin e objektit dhe ambienteve të veçanta të tij...* Sigurimi i një komforti termik të përshtatur për secilin ambient duke veçuar tipologjitë e veçanta funksionale, të tilla si salla mësimi, laboratorë, salle mesuesish dhe zyra administrative është domosdoshmëri. Nisur nga vëllimi i madh i punimeve, sjell nevojën që minimalisht të angazhohen në zbatimin e punimeve dy ekspertë inxhinierë mekanikë të licensuar. Vëllimi i madh i punës mund të përballohet duke parashikuar edhe një inxhinier mekanik, i cili mund të jetë ose jo detyrimisht i përfshirë në licensën e shoqërisë. Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe mos rëndimin e OE nga AK është kërkuar që detyrimisht të jetë në licensën e shoqërisë të paktën një inxhinier mekanik. Inxhinieri i dytë i licensuar i nevojshëm mund të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë, ose mund të jetë i pajisur me licensë profesionale individuale.

-Inxhinier hidroteknik .Objekti i parashikuar të rikonstruktohet do të përmbajë një numër të konsiderueshëm tualetesh higjieno – sanitare. Për realizimin e projektit hidroteknik të godinës, zbatuesi duhet të mbështetet në projektin, relacionin, specifikimet teknike, preventivin dhe grafikun e punimeve hidroteknike. Punimet duhet të realizohen në përputhje me zgjidhjet teknike dhe specifikimet e projektuesit. Për drejtimin teknik të këtyre punimeve është e nevojshme që të angazhohen minimalisht një inxhinier hidroteknik i përfshirë në licensën e shoqërisë. Inxhinieri Hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar zerave hidroteknike, etj.

-Inxhinier gjeodet: Gjatë zbatimit të punimeve të nëntokës është e domosdoshme që të mbahen në konsideratë faktorët gjeologjikë, integrimi i projektit me ndërtesa dhe ambientin përreth, kërkesat konstruktive dhe teknike dhe rrjetet nëntokësore. Puna për pozicionimin e zbatimit e themeleve duhet të kryhet pasi të bëhet vlerësimi përgatitor për vendin e punës. Duhet të merren masat për sigurimin e ndërtesave ngjitur. Për ndjekjen e punimeve të tilla dhe shmangien e ngjarjeve të rrezikshme, apo marrjen e masave për zgjidhjen e problematikës konstruktive nga një ngjarje eventuale është e domosdoshme që pjesë e stafit inxhinierik të OE të jetë edhe të paktën një inxhinier ndërtimi gjeodet. Ai duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë si drejtues teknik, duke qenë se drejtuesit ligjorë dhe teknikë të OE janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës.

Ofertuesve nuk u lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera si drejtues teknik i sipërpërmendur, vlerësohen si kapacitete të lidhur ngushtësisht me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme për shkak të rëndësisë së veprës, punimeve në fasadë dhe punimeve në objekt prokurimi, dhe janë të nevojshme për të krijuar bindjen te Autoriteti Kontraktor se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standarteve të kërkuara.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentim Ligjor dhe Teknik : Autoriteti Kontraktor këto kritere i ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6.

Keto kritere i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për tu bindur se OE zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Këtu nga AK janë përcaktuar kriteret e nevojshme për personelin e kualifikuar sipas niveleve të ndryshme të kualifikimit dhe profileve të nevojshme mbështetur në tipologjinë e punimeve, si dhe kërkesat për fuqi punëtore referuar përmasave dhe natyrës së kontratës, objekt prokurimi.

Në kërkesat për personelin e kualifikuar nga AK janë kërkuar disa kategori personeli, të domosdoshëm për të kryer të gjitha shërbimet e nevojshme dhe mbulimin e të gjitha hallkave/etapave të zbatimit të projektit, sipas nivelit të kompetencave profesionale deri në realizimin e plotë të veprës.

Në kërkesat për personelin e kualifikuar janë kërkuar ekspertët arkitektë dhe inxhinierë të licensuar, sipas profileve të domosdoshme për të mbuluar të gjitha punimet e parashikuara në projekt – zbatimin e parashikuar të relizohet nëpërmjet kësaj kontrate. Një pjesë e këtyre ekspertëve duhet të jenë të përfshirë në licensën e shoqërisë, ndërsa pjesa tjetër jo domosdoshmerisht të përfshirë në licensën e shoqërisë, por me kontrate pune/kontrate bashkepunimi.

-Inxhinier ndertimi :Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një sasi dhe tipologji të madhe të punimeve të përgjithshme ndërtimore, të tilla si punimet e prishjes, punimet e gërmimit, punimet e shtresave, punimet e muraturës, suvatimet, hidroizolimet, sistemimet e jeshtme etj. Punimet ndërtimore përbëjnë pjesën më të madhe të vëllimit të punëve për zbatimin e projektit, sikurse edhe ato më komplekset. Punimet e ndërtimit duhet të përmbushin kushtet teknike të zbatimit. Respektimi i kërkesave për qëndrueshmëri strukturore dhe qëndrueshmëri, plotësimi i kërkesave për mbrojtjen pasive nga zjarri, përdorimi i materialeve që nuk janë të dëmshëm për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve dhe saktësia në realizimin e të gjithë elementëve konstruktivë sjellin domosdoshmërinë që çdo element dhe hallkë e zbatimit të këtyre punimeve të ndiqet dhe udhëhiqet nga ekspertë të licensuar të fushës.

-inxhinieri elektrike të licensuar nga të cilët minimalisht një duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë. Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe mos rëndimin e OE nga AK është kërkuar që detyrimisht të jetë në licensën e shoqërisë të paktën një inxhinier elektrik. Inxhinieri i dytë i licensuar i nevojshëm mund të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë, ose mund të jetë i pajisur me licensë profesionale individuale.

2.10 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe *stafin*

mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi 1(nje)
- Inxhinier Elektrik 1(një)
- Inxhinier Mekanik 1(një)

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për te paktën tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (*e vlefshme*)/kontrate bashkepunimi, librezë pune, C.V.

Ofertuesve nuk u lejohet mbështetja në kapacitet e subjekteve të tjera si drejtues teknik i sipërpërmendur, vlerësohen si kapacitete të lidhur ngushtësisht me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme për shkak të rëndësisë së veprës, punimeve në fasadë dhe punimeve në objekt prokurimi, dhe janë të nevojshme për të krijuar bindjen te Autoriteti Kontraktor se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standarteve të kërkuara.

-Inxhinier ndertimi :Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një sasi dhe tipologji të madhe të punimeve të përgjithshme ndërtimore, të tilla si punimet e prishjes, punimet e gërmimit, punimet e shtresave, punimet e muraturës, suvatimet, hidroizolimet, sistemimet e jeshtme etj. Punimet ndërtimore përbëjnë pjesën më të madhe të vëllimit të punëve për zbatimin e projektit, sikurse edhe ato më komplekset. Punimet e ndërtimit duhet të përmbushin kushtet teknike të zbatimit. Respektimi i kërkesave për qëndrueshmëri strukturore dhe qëndrueshmëri, plotësimi i kërkesave për mbrojtjen pasive nga zjarri, përdorimi i materialeve që nuk janë të dëmshëm për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve dhe saktësia në realizimin e të gjithë elementëve konstruktivë sjellin domosdoshmërinë që çdo element dhe hallkë e zbatimit të këtyre punimeve të ndiqet dhe udhëhiqet nga ekspertë të licensuar të fushës.

-Inxhinier elektrik. Punimet elektrike përfshijnë zëra me vlera të konsiderueshme në prevetivin total të punimeve. Zërat e përfshirë në preventiv shoqërohen me zgjidhet teknike të hartuara nga eksperti inxhinier elektrik në projekt, në relacionin teknik dhe specifikimet teknike. Të tilla punime janë punimet për kuadrot elektrike, sistemin e fuqisë dhe ndriçimit, sistemi i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike dhe tokëzimi, tokëzimi i përsëritur te kuadri kryesor i godinës, si dhe punimet për motimin e gjeneratorit dhe kabinës elektrike. Në vëllimet e veçanta të ndërtesës në periudha të caktuara të realizimit të punimeve sipas grafikut, do të punohet paralelisht. Për këtë arsye, lind nevoja që për zbatimin e punimeve në të gjitha vëllimet e objektit të angazhohen minimalisht 1 (nje) inxhinier elektrike të licensuar nga te cilet minimalisht nje duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë. Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe mos rëndimin e OE nga AK është kërkuar që detyrimisht të jetë në licensën e shoqërisë të paktën nje inxhinier elektrik. Inxhinieri i dytë i licensuar i nevojshëm mund të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë, ose mund të jetë i pajisur me licensë profesionale individuale.

-Inxhinier mekanik Projekti që do të zbatohet nëpërmjet kësaj procedure prokurimi përmban si komponent të tij edhe projektin HVAC (projektin e ngrohjes ftohjes dhe ventilimit). Ky projekt përmban zgjidhjet grafike, relacionin teknik, specifikimet teknike dhe preventivin e realizimit të punimeve të tilla. Realizimi i këtij projekti për të gjithë vëllimet e objektit është shumë i rëndësishëm për sigurimin e komfortit termik në ambiente. Sikurse shtjellohet në realcionin teknik përkatës, *parametrat projektuese të projektit janë marrë në përputhje me tipin dhe destinacionin e objektit dhe ambienteve të veçanta të tij...* Sigurimi i një komforti termik të përshtatur për secilin ambient duke veçuar tipologjitë e veçanta funksionale, të tilla si salla mësimi, labororë, salle mesuesish dhe zyra administrative është domosdoshmëri. Nisur nga vëllimi i madh i punimeve, sjell nevojën që minimalisht të angazhohen në zbatimin e punimeve dy ekspertë inxhinierë mekanikë të licensuar. Vëllimi i madh i punës mund të përballohet duke parashikuar edhe një inxhinier mekanik, i cili mund të jetë ose jo detyrimisht i perfshire ne licencen e shoqerise. Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe mos rëndimin e OE nga AK është kërkuar që detyrimisht të jetë në licensën e

shoqërisë të paktën nje inxhinier mekanik.

Argumentimi Ligjor dhe Teknik :

AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin e mësipërm, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar jo domosdoshmërisht të përfshirë në licensën e shoqërisë është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi

2.12 Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizma të akredituar:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

-Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë SSH/DIN/EN/UNI ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH/DIN/EN/UNI ISO 9001:2015 ose ekuivalente.

-Çertifikatën e menaxhimit të siguri dhe shëndetit SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001-2018 ose certifikatën për standardin e përditësuar ISO 45001-2023, (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001-2018 ose certifikatën për standardin e përditësuar ISO 45001-2023 ose ekuivalente.

Argumentim Ligjor dhe Teknik: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.10 janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e

cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001-2018/45001-2023 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

2.13 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njësi	Sasia	Statusi
1	Eskavator me Goma (mjet teknologjik)	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
2	Eskavator me me zinxhire	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
3	Fadrom me goma me kove para mbrapa (mjet teknologjik)	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
4	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 20 deri 25 ton	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
5	Kamionçinë deri në 0.2- 3.5 ton	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
6	Kamion me Vinç me kapacitet mbajtës të Vinçit 7 deri 8 ton	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
7	Autoboot Uji	Copë	1	Ne pronesi ose me qera

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njësi	Sasia	Statusi
8	Autobetonierë vetngarkuse 1-3,5 m3 (mjet teknologjik)	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
9	Autopompe betoni	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
10	Gjenerator	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
11	Matrapik	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
12	Vibrator	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
13	Minieskavator	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
14	Rul Hekur Hekur mbi 2 ton	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
15	Rul Hekur Hekur 8 deri ne 10 ton	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
16	Saldratrice	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
17	Pompe Suvatimi	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
18	GPS	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
19	Total Station	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
20	Skela Metalike	m2	1000	Ne pronesi ose me qera
21	Depozite Uji 5000 litra	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
22	Greider (mjet teknologjik)	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
23	Rul hekur gome 18-20 tone	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
24	Zyre Kontenier	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
25	Minifadrom bobcat (mjet teknologjik)	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
26	Asfalto shtruese	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
27	Autobetoniere	Copë	2	Ne pronesi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 60 copë
 - Ripa sigurimi për punime në lartësi minimumi 10 copë
 - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
 - Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
 - Uniforma / Jelek pune 60 cope
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë
- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
 - b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash, për rripat e sigurimit dhe makineri ngritëse të paraqiten certifikatat e inspektimit të vlefshme.
 - c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.
 - d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
 - e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në

përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese.

- f)** *Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të saktësisë së informacionit. Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo të rremë do të konsiderohet kusht për skualifikim.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK

Specifikimet teknike, termat e references, raporti teknik, preventivi me zerrat e punimeve janë pjesë DST

Shënim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi Ligjor dhe Teknik : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira / kontrate furnizimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Gjithashtu për përcaktimin e numrit të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjisllacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Specifikimet teknike, termat e references, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve jane pjese DST

Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr.285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit, për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike/termat e referencës të përcaktuara në procedurën e prokurimit; si dhe përcaktimin e nenit 78, pika 4, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021, i sipërcituar, sipas të cilit: “Pas nënshkrimit të njoftimit të kontratës nga titullari i autoritetit kontraktor, personi/at përgjegjës për prokurimin dërgon/jnë dokumentet e tenderit dhe procesverbalin e argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike, termat e referencës dhe kriterëve për kualifikim, për publikim, në përputhje me nenet 55 e 56, të LPP-së.”

Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit --, të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, që çdo kriter i vecantë është në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike /Relacioni Teknik grafik i punimeve për këtë procedure janë hartuar nga qe ka hartuar edhe projekt/preventivin përkatës të zbatimit duke qenë elemente përbërës të tij dhe janë verifikuar nga specialistët e fushës. Dokumentet janë kontrolluar dhe janë gjetur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”. Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e

autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve që do të realizohen në objekt, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e objektit të punës, në përputhje me nenin 4, pika 3/b dhe neni 36, të LPP (i ndryshuar), dhe të Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJESIA E PROKURIMIT